



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°13/2021

Hagë, 09/12/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Të premten e shkuar më 3 dhjetor, Mbrojtja e z. Gucati në gjykimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, bëri deklaratën hyrëse.

Ditën e hënë, Mbrojtja e Gucatit thirri z. Gucati si dëshmitarin e vet të parë. Atij i drejtoi pyetje Mbrojtja të hënën ndërsa të martën dhe të mërkurën i drejtoi pyetje Prokurori i Specializuar. Anëtarët e Trupit Gjykses i bënë gjithashtu disa pyetje.

Sot dhe nesër Trupi Gjykses do të dëgjojë një numër dëshmitarësh të tjerë, anëtarë të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe gazetarë. Çështja Hysni Gucati pritet të përfundojë javën e ardhshme, pas së cilës Mbrojtja e Haradinajt pritet të fillojë paraqitjen e provave.

Gjithashtu ditën e hënë Trupi Gjykses për këtë çështje gjyqësore urdhëroi Prokurorinë dhe Mbrojtjen të dorëzonin parashtrime me shkrim lidhur me raportin e Policisë së Kosovës si dhe raportin e Zyrës Administrative në lidhje me sistemin e paraburgimit në DHSK, përkatësisht brenda datave 10 dhe 16 dhjetor.

Gjithashtu, Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorinë të dorëzojë me shkrim brenda datës 10 dhjetor pikëpamjen e saj lidhur me domosdoshmërinë e vazhimit të paraburgimit për z. Gucati dhe z. Haradinaj dhe Mbrojtja të përgjigjet brenda datës 16 dhjetor 2021. Urdhrin mund ta lexoni në faqen zyrtare të internetit të DHSK-së.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°13/2021

Hagë, 09/12/2021

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, seancat gjyqësore janë planifikuar të mbahen të hënën, të martën dhe të mërkurën e javës së ardhshme. Dëshmitari i radhës i thirrur nga Prokurori i Specializuar për të dëshmuar në këtë çështje është planifikuar të dëshmojë me masa mbrojtëse, ku përfshihet ndryshimi i zërit, fytyrës dhe përdorimi i një pseudonimi.

Ky do të jetë dhe dëshmitari i fundit që dëshmon për këtë çështje gjyqësore këtë vit. ZPS-ja ka bërë me dije se synon të thërrasë tre dëshmitarë të tjerë në muajin janar dhe në fillim të shkurtit 2022.

Në çështjen *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, është planifikuar që të mbahet një seancë përgatitore të mërkurën më 15 dhjetor në orën 14:30.

Temat që do të diskutohen përfshijnë një numër aspektesh lidhur me nxjerrjen e provave nga Prokuroria dhe Mbrojtja, përkthimin e listës paraprake të dëshmitarëve të ZPS-së, ecurinë e hetimeve dhe dorëzimin e dosjes paraprake të Prokurorit të Specializuar.

Në të njëjtën çështje, versionet e redaktuara të vendimeve më të fundit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi rishikimin e mbajtjes në paraburgim të z. Krasniqi, z. Selimi dhe z. Veseli janë bërë publike dhe mund të shihen në faqen tonë të internetit.

**Pyetje nga gazetarët
Nuk pati pyetje**

